REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:017285

Datë: 08.10.2019

Numri i dokumentit: 00568452

P.nr.1802/17

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari Adem Shabani, me procesmbajtësen- praktikanten Valjeta Topalli, në çështjen penale kundër të akuzuarit M.O, me vendbanim në .....,i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2325-5/16 e dt. 19.07.2017, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 par.1 të KPRK-së, ku në shqyrtimin gjyqësor prokurori i shteti bazuar në neni 3 paragrafi 2 të KPRK-së, Kodi penal Nr.06/L-074 i cili ka hyrë në fuqi me dt.14.04.2019 ka rikfalifikuar në kryerjen e veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së,në prezencen e përfaqësuesit të dëmtuarës KEDS-it Distrikti në Ferizaj ....., të akuzuarit M.O, me datën 08.10.2019 solli dhe publikisht shpalli këtë:

A K T GJ Y K I M

I akuzuari M.O, me vendbanim në ....., ku edhe tani jeton, i lindur me....., shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosoves ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, me profesion mekanik, me numër personal .....-

ËSHTË FAJTORË

SEPSE:

- Me daten 08.08.2016, në kohe te pacaktuar ne fshatin....., me rastin e kontrollit në punëtorin Automekanik "....." Të pandehurit , nga ana e punetoreve te autorizuar te KEDS-it, kane hasur te konsumatori keqpërdorim të energjisë elektrike , në atë mënyrë Që konsumatori ka bërë nderhyrje të paautorizuar duke u kycur direkt në furnizim të energjise elektrike jashte pikes matese pa njehsore elektrik , ku energjia e shfrytezuar nuk regjistrohet fare , me të cilin rast keds-i lokalin e tij në në fshatin ....., nga puntorët e KEDS-i eshte dëmtuar në shume prej 941.37 €,-

2018:017286

Me të cilën ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve **nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së .**

Andaj gjykata në bazë të neneve 3, 4, 7, 8, 9, 10, 17, 38, 39, 46, 47, 49 dhe 69 të KPRK-së, dhe neneve 361, 365 dhe 450 dhe neni 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPPRK-së e

GJ Y K O N

Të akuzuarit M.O, i shqipton dënimin me kusht me burg prej 4 / katër / muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

Përfaqësuesin juridik të KEDS-it, Distrikti në Ferizaj për realizimin e kërkesës pasurore juridike lidhur me dëmini që i'u është shkaktuar e ka udhëzuar në kotest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 20 €, dhe taksën në shumën prej 30 €uro, konform nenit 39 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit për Kompenzimin e Viktimave të Krimit, këto në fat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr. 2325-5/16 e dt. 19.07.2017, me të cilën ka ngarkuar të akuzuarin I akuzuari M.O, me vendbanim në ....., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPRK-së, me datën 24.01.2018, ka mbajtur shqyrtimin fillestar, ku i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 par.1 të KPRK-së.

Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 245 paragrafi 6 dhe neneve 249 dhe 250 të KPPRK-së e ka udhëzuar të akuzuarin se mundë të paraqet prova për kundërshtimin e aktakuzës apo kërkesë për hudhjen e aktakuzë .

Gjykata shqyrtimin kryesor në këtë çeshtje penale ka mbajtur me dt.08.10.2019, ku ka ftuar të akuzuarit të përcjellë me vëmendje zbatimin e shqyrtimit gjyqësor duke e udhëzuar të akuzuarin në kuptim të nenit 323 parag.2.1,2.2 dhe 2.3 të KPPK-së.

Prokurori i shtetit Avdullah Abedini përsëri edhe në shqyrtimin kryesor të akuzuarit i ka lexuar aktakuzën dhe pas leximit gjyqtari është bindur se i akuzuari e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe i ka ofruar mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë lidhur me veprat penale për të cilat akuzohen.

I akuzuari B.I , nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

2018:017286

Pasi i akuzuarit nuk e ka pranuar fajsinë në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ka ftuar prokurorin e shtetit për të përmbledhur provat që mbështesin rastin konform nenit 328 par 1.të KPPRK-së.

Konform nenit 329 të KPPRK-së gjykata ka bërë prezentimin e provave që i ka konsideruara të rëndësishme për një gjykim të saktë dhe të drejtë.

Dëshmitari A.T punëtorë në KEDS- Distrikti në Ferizaj, në shqyrtimin gjyqesore ka deklaruar se: është e vërtetë se me datën 08.08.2016 kemi qenë ne kontrolle ne lokalin Automekanik "..... " në fshatin ... mirëpo nuk më kujtohet se ae kemi takuar të pandehurin por prezent ka pasur persona të tjerë, dhe lokali ishte ne funksion dhe më kujtohet se në këtë lokal ishte duke punuar si auto mekanik dhe një koleg i punës na ka ftuar se ishte tek lokali në fjalë duke na thënë se në të njëjtin lokal është dujke u keqpërdorë shfrytëzimi i energjisë elektrike dhe menjëherë kur kemi arritur aty kemi konstatuar se ishte duke u keqpërdore dhe atë dy faza te furnizimit me energji elektrike ishin jashtë pikës matëse qe do te thotë se nuk ka pasur kyçje ne njësorin elektrik në vazhdim deklaron se KPO do të thotë se furnizimi me rryme elektrike vjen nga shtylla elektrike në KPO në ormanin e siguresave ku dy faza kanë qenë të lidhura drejtpërdrejtë jashtë njësorit elektrik ku 66.6 % nuk është matur dhe hargjimi i energjisë së shpenzuar meqë nuk ka qene i lidhur ne njësorin elektrik dhe ne lokal siç e di unë ka pasur edhe mjete qe janë furnizuar me energji elktrike dhe atë vinçi(lift) për ngritjen dhe uljen e veturave, dy brusalica, ni nxemse elektrike dhe disa drita për ndriqim dhe gjitha këto mjete qe gjenden ne këtë lokal kemi bërë edhe procesverbal dhe unë jam i pari qe kam nënshkruar me nr. te ID 11708 dhe me pas sa me kujtohet personi që është prezent në sallë në cilësinë e të pandehurit ka ardhur në lokalin e punës dhe e kemi njoftuar për te gjeturat te cilat ishin jashtë lidhjes ne njësorin elektrik por i njëjti nuk ka pranuar dhe nuk e ka nënshkruar procesverbalin, ku ne gjatë kontrolles kemi bërë foto te njësorit elektrik dhe kabllove qe ishin te kyçura ne njësorin elektrik ne kemi marre veprime për ti eliminuar këto lidhje jashtë njësorit elektrik qe ishin lidhje direkte dhe i kemi kyqur ne menyre te rregullt.

Deshmiatri S.Q punëtorë në KEDS- Distrikti në Ferizaj, në shqyrtimin gjyqesore ka deklaruar se eshtë e vërtetë se ate dite se bashku me koleget e tjerë kemi qenë në kontrollë tek lokali ne punëtorinë e automekanikit- te pandehurit në .... ku lokali ishte duke punuar, dhe kemi takuar personin qe ishte duke punuar aty. Pasi kemi arritur tek lokali kolegu ynë ka lexuar njësorin ku kemi dyshuar dhe siç duket nuk ishte ne rregull, dhe pasi i njëjti e ka kontrolluar ka konstatuar se konsumatori është kyçur direkt me furnizim te energjisë elektrike jashtë pikës matëse ,ku dy faza prej KPO deri ne siguresa dhe energjia e hargjuar nuk është regjistruar si e

2018:017286

shpenzuar, dhe disa pajisje qe kane qenë në lokal të kyçura me furnizim të energjisë i kemi hartuar ne procesverbal mirëpo nuk më kujtohet se a kanë qenë të kyçura ne rrjet, dhe procesverbalin e kam hartuar unë personalisht me nr. i ID nr. ....dhe procesverbalin i kam ofruar shfrytëzuesit- i cili sot është prezent ne seancën e sotme gjyqesore ne cilësinë e te dyshuarit por i njëjti nuk e ka nënshkruar, dhe me kujtohet se kemi bërë edhe fotografimin e lidhjeve qe ishin jashtë pikës matëse, të cilat i kemi bashkangjitur procesverbalit, por sjelljet e personit qe akuzohet kane qenë të mira.

Në shyqrtimin gjyqësor gjykata në fazen e nxjerrjes së provave ka lexuar: Procesverbali nr.....i datës 08.08.2016 te cilën punëtoret e KEDS-it e kane përpiluar ne kohen e kontrolles, dhe kane konstatuar se i njëjti ka qene i lidhur direkt dhe energjia e hargjuar nuk është regjistruar fare, fatura .... e datës 09.08.2016 vërtetohet se i pandehuri M.O ka një borxh prej 941.37 € po ashtu e njëjta gjendje do te vërtetohet edhe nga fotografit e njësorit elektrik te bere nga punëtoret e KEDS-it me rastin e kontrollit te njësorit elektrik.

I akuzuari M.O në shqyrtimin gjyqesore në mbrojtjen e dhene ka deklaruar se qe nga vitin 2016 kam pasur një lokal me qera të punës ne .... si auto servis "..." në ..... dhe lokalin qe e kam shfrytëzuar ka qenë pronë e I.Q, dhe atë lokal e kam shfrytëzuar me qera, dhe shpenzimet e energjisë elektrike të shpenzuara në këtë lokal i kam paguar rregullisht. Siç me kujtohet këtë lokal kam filluar ta shfrytëzoj ne muajin Qershor 2016 deri ne Prill ose Maj 2017 dhe harxhimi i energjisë elektrike ne fillim kanë ardhë me një shume 6 deri 7 € , por në fature k qenë nje borxh i mbetur në shume prej 200 €, nga shfrytëzuesi i mëhershëm i lokalit. Eshtë e vërtetë se punëtorët e KEDS-it kishin ardhur në kontrollë ku unë nuk isha aty por ka qenë djali im dhe kur kam ardhur ne lokal punëtoret e KEDS-it ishin prezent e se bashku me ta ishte edhe pronari i lokalit I.Q.Punëtorët e KEDS-it pasi kishin kontrolluar lokalin të njëjtit kishin përpiluar procesverbal dhe me kërkuan letërnjoftimin ku të njëjtëve ja kam ofruar dhe pastaj më kanë ofruar qe ta nënshkruaj por unë nuk e kam nënshkruar pasi qe me njoftuan me përmbajtjen e këtij procesverbali se une kam keqpërdorur energjinë elektrike, kam bere ndërhyrje të paautorizuar, duke u kyqur direkt ne furnizim me energji elektrike jashtë pikës matëse duke anashkaluar njehsorin elektrik une i njoftova punëtorët e KEDS-it se nuk eshte kjo e veretë dhe kjo ka qene arsyeja qe une nuk e kam nënshkruar. Ne vazhdim te shyrtimit gjyqesore e njofton gjykatën se sipas njohurive qe kam ky njësor ka qenë vetëm për lokal jo edhe për shtëpi, Fatura për pagesën e energjisë elektrike ka ardhur ne emër te pronarit te lokalit por unë borxhin tim e kam paguar ne KEDS dhe nuk e ndjej veten fajtorë për këtë

2018:017286

vepër penale. Edhe pse ka qene njehsori elektrik monofaze unë e kam perdorte rrymën trefaze me qe lifti i ngritjes dhe leshuarjes së veturave nuk mund te punoj pa furnizim me energji elektrike trefazëshe, por priza furnizues ne lokal qe e kam shfrytëzuar une ka qene tre faze ashtu sic instalohet ne shtëpi, por me kujtohet se punetoret e KEDS-it e kanë rregulluar furnizimin me rryme dhe une panderhyrje ne njesore apo jashtë njësorit si me herët e kam shfrytëzuar te njetn prizë.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar, pasi Kodi Penal nr 06-L- 074 i cili ka hyre ne fuqi me 14.04.2019 ku në nenin 314 ka paraparë veprën penale vjedhja e shebimeve nga paragrafi 1 ku dënohet me gjobë ose me burgim deri 3 vjet, në kuptim te nenit 3 te këtij Kodi penal zbatohet instituti i zbatimit të ligjit më të favorshëm konkretisht në paragrafin 2 ku thuhet ” ne rast se ligji ne fuqi ndryshon para shqyrtimit te vendimit te formës se prerë atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është me i favorshëm ” e në ketë rast vie në shprehje neni 314 paragrafi 1.i KPRK-së. Pas administrimit të proveve, dëgjimit të dëshmitarëve- punëtorëve të KEDS-it, A.T dhe S.Q si dhe leximit të provave si dhe leximit të provave qe gjenden ne shkresat e lendes procesverbali nr.1349047 i datës 08.08.2016 te cilën punëtoret e KEDS-it e kane përpiluar ne kohen e kontrollit, dhe kane konstatuar se i njëjti ka qene i lidhur direkt dhe energjia e harxhuar nuk është regjistruar fare, fatura DFE 16 HP 1253 e datës 09.08.2016 vërtetohet se i pandehuri M.O ka një borxh prej 941.37 € po ashtu e njëjta gjendje do te vërtetohet edhe nga fotografit e njësorit elektrik te bere nga punëtorët e KEDS-it me rastin e kontrollit te njësorit elektrik si dhe shikimi i foto dokumentacioni që gjenden në shkresat e lendës u vertetua gjendja faktike e pershkruar ne dispozitivin e kësaj aktakuze si dhe kualifikimi ligjor , andaj i propozojmë gjykatës që i pandehuri te shpallet fajtorë për veprën penale për te cilën edhe është akuzuar dhe ti shjqiptoj sanksion penale te parapare me ligj.

Përfaqësuesi Juridik i KEDS-it-Distrikti në Ferizaj, B.S, në shqyrtimin gjyqësor në fjalën përfundimtare deklaron se bashkëngjitet ndjekjes penale , e mbështetës në tërsi fjalën e prokurorit të shtetit, dhe mbetet në propozim për realizimin e kërkesës pasurore juridike qëi pandehuri i ka shkaktuar dëm material të dëmtuarës KEDS-it –Distrikti në Ferizaj në shumën e precizuar në dispozitivin e aktakuzës.

Në shqyrtimin gjyqësor i akuzuari M.O në fjalën përfundimtarë deklaron se nuk e ndien veten te fajshëm dhe kërkon nga gjykata qe te lirohet nga përgjegjësia penale meqë nuk është e vërtetë se unë pa autorizim jam kyçur direkt në furnizimin me energji elektrike por ashtu siç e kam pranuar nga pronari kam vendosur pajisjet për pune pa pasur kurrfarë ndërhyrje ne njësorë elektrik apo kyqje direkte siç pretendon KEDS-i gjithashtu çdo muaj ka shkuar tek distribucioni dhe ka paguar sipas muajve shpenzimet e shkaktuara, andaj i propozoj gjykatës te

2018:017286

me liroj nga përgjegjësi penale dhe për dëmin qe e kërkon përfaqësuesi i te dëmtuarës mos ta aprovoj si te bazuar pasi qe une nuk i kam mbetur borxh KEDS-it.

Gjykata duke u bazuar në nenin 7, 8 dhe nenin 361 par.1 dhe 2 të KPPRK-së vlerësoi provat një nga një dhe të gjitha së bashku si dhe lidhje me provat që gjinden në shkresat e kësaj lënde penale vërtetoi gjendjen faktike si të përsdhkruar si ne dispozitiv të aktakuzës.

Gjendjen e përshkruar faktike gjykata e vërtetoj në bazë të deponimit të dëshmisë së dëshmitarëve A.T dhe S.Q ,punëtore të KEDS-it, Procesverbali nr.1349047 i datës 08.08.2016 te cilën punëtoret e KEDS-it e kane përpiluar ne kohen e kontrolles, dhe kane konstatuar se i njëjti ka qene i lidhur direkt dhe energjia e hargjuar nuk është regjistruar fare, fatura....e datës 09.08.2016 vërtetohet se i pandehuri M.O ka një borxh prej 941.37 € po ashtu e njëjta gjendje do te vërtetohet edhe nga fotografit e njësorit elektrik te bere nga punëtoret e KEDS-it me rastin e kontrollit te njësorit elektrik.

Dëshmive të sipërcekura gjykata i u shprehi besimin e plotë pasi që dëshmitarët në mënyrë detale kanë përshkruar veprimet inkriminuese të akuzuarit të cilat dëshmi janë në harmoni të plotë dhe plotësohen reciprokisht edhe me provat tjera që gjinden në shkresat e kësaj lënde penale**.**

Mbrojtjen e të akuzuarit se nuk ka nderhyre ne furnizim me energji elektrike dhe kinse eshte kyqur direkt ne furnizim me energji elektrike jashtë pikës matëse pa njesore elektrik gjykata e vlersonë si të pa bazuar dhe të orjentuar në drejtim të justifikimit të veprimeve inkriminuese, pasiqë nji mbrojtje e tillë është jo bindëse dhe në kundërshtim me provat tjera të zbatuara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Mbi gjenden e tillë të fakteve dhe vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjiths elementet e veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së e rikualifikuar ne shqyrtimin gjyqesore në veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes se llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e tij në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, si rrethanë lehtesuese gjykata mori, është hera e parë që ndeshet me ligjin, pasi që nga vërtetimi i të dhënave gjykata nuk ka hasur qe injejti ka apsur ndonjë vepër tjetër penale, sjelljet korrekte gjatë zhvillimit të procedurës penale, eshte mbajtës i familjes , i martuar, nga arsyrat e lartë theksuara dhe në kuptim të të gjitha këtyre, i shqipton dënimin me kusht me burg prej 4 (katër) muajve, të cilat dënime nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale, duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit dhe me te arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që i akuzuari të mos kryejë vepra penale si dhe

2018:017286

në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.

Gjykata konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par 2.të KPPK-së , Përfaqësuesi ligjor i KEDS-it zyra në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së dhe nenit 39 parag.1 nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e viktimave të krimit Nr.05/L-036.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,
P.nr.1802/17 me datë 08.10.2019

Procesmbajtëse-praktikante **Gjyqtari**
Valjeta Topalli Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

2018:017286